

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr _____ Prot.

Urë Vajgurore më ____/____/2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - PUNË.

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikualifikim llixha –faza e dytë”

KODI NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime ndertimi 45210000-2

VLERA E FONDIT LIMIT: 21 666 667 (njëzet e një milion egjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia DIMAL, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas shtojcës 8

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron minimale vjetore për tre vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 80% e fondit limit të kontratës që prokurohet.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Autoriteti kontraktor, në përcaktimin e vlerës së xhiros minimale vjetore (dhe konkretisht jo më pak se 80% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet) ka mbajtur në konsideratë nenin 43 pika 2 gërma b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku shprehimit thotë se :

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

- a) dyfishin e vlerës së përlogariturtë kontratës ose lotit¹, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
- b) **vlerën e përlogariturtë të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;**
- c) 40 % të vlerës së përlogariturtë të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të japin informacione në bilancet e tyre vjetore për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, që të

tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 dhe kestet e maturuara për vitin 2025, duke mbajtur në konsideratë dhe përcaktimet e Ligjit Nr 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, pranë njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij sipas QKB-së.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Kjo pikë përmbshet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8)

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e

shpalljes së njoftimit të kontratës,ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 200 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e një kontrate të ngjashme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm :

- Për kontrata për punë publike të realizuar me institucione shtetërore kërkohen:

- a) *Kontraten/at e Sipërmarrjes,*
- b) *Situacion përfundimtare të objektit,*
- c) *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës përkatëse,*
- d) *Akt Kolaudimi*
- e) *Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore*
- f) *Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm dhe/ose përfundimtare*

- Për kontrata për punë publike është realizuar me subjekte private kërkohen:

- a) *Kontraten/at e Sipërmarrjes,*
- b) *Situacion përfundimtare të objektit,*
- c) *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës përkatëse.*
- d) *Akti i Kolaudimit*
- e) *Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore*
- f) *Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm dhe/ose përfundimtare*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë jo më e vogël se **40 %** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël **180%** të vlerës së fondit limit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast për zgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- N.P –1 A (Punime gërmimi në tokë)
- N.P – 4 A (Rruge, autostrata, mbikalime, hekurudha, tramcai, metro, pista aeroportuale)
- N.P – 5 A (Punime nëntoksore, ura e vepra arti)
- N.P – 11 A (Ndertime për N/Stacionet, kabinat e transformatoreve, linja e TN të mesem dhe shpërndarjes së energjisë)
- N.P - 12A (Punime të inxhinierisë së mjedisit)

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- N.S - 4 A Punimerifiniturë të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.
-
- N.S - 18 A Punimet opogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukurës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në Nr.42, datë 16.01.2008).

Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

• Kategoria NP-1 A (Punime gjërmimi në tokë)

Konsiderohen gjërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjërmohet ose sistemohet, vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Referuar zërave të preventivit dhe sasisë së punimeve të cilat përfshijnë gjërmimet për Gjërmime gjithsej me makineri në prani uji për themel në sasinë 400 m³, Gjërmim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m³ në kanale gjëresi deri 2 m, prani uji ~1m, kategoria III, me shk në toke për devijim lumi në sasinë 1500 m³, Gjërmim themel, shkëmb bute, h=2.5m, makineri, prani uji (gjërmim shkëmb i bute për themele për ballnat, shpatullat e muret mbajtes) në sasinë 285 m³, Gjërmim themel, shkëmb bute, h=2.5m, makineri, prani uji (gjërmim shkëmb i bute për themele për ballnat, shpatullat e muret mbajtes në sasinë 355 m³ etj, operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

N.P – 4 A (Rruge, autostrata, mbikalime, hekurudha, tramcai, metro, pista aeroportuale)

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvaji, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrore dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi "goma", "hekur", "zona", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

N.P – 5 A (Punime nëntokësore , ura e vepra arti)

Konsiderohen. Ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntokësore që janë të lidhura me ndërmërimin e lëvizshmërisë mbi "goma" ose mbi "hekur", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele.

Referuar objektit të prokurimit, njësia e prokurimit gjykon se licenca e mësipërme përputhet plotësisht.

N.P.11 A Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e tensionit të lartë dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloji tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.

Zerat e preventivit të cilat përmbajnë punimet elektrike të cilat janë të konsiderueshme janë të argumentuara dhe të mbuluara nga kjo pikë e licences. Kjo duke patur parasysh që nuk ka një pikë të vecantë të licences për të mbuluar këto zera preventivi.

N.P - 12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit)

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësisë të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësisë natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore,

dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjike, nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierve dhe mbetjeve inerte

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

N.S - 9 A Punime Strukturore Speciale

Konsiderohet ndërtimi i objektit i destinuar për transmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuara për t'u ndërtuar në terrene rezistente dhe jo të deformueshme, por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotëve të çfarëdolloj tipi, të themeleve nëntokësore me pilotë ose me mure mbajtëse, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përfshirë edhe marrjen e kampioneve për analiza laboratoriale nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve. Impermeabilizzazione dhe konsolidimin e terreneve.

Kërkesa që operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë liçensën NS 9 A është një kërkesë në përputhje dhe vëllim të plotë me objektin e prokurimit dhe njëkohësisht garanton autoritetin kontraktor për zbatimin me sukses të kontratës dhe në kohë.

NS - 18 A (Punime Topogjeodezike)

Konsiderohet zbatimi i rëlvimeve topografike special që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta

Në këtë objekt përfshihen edhe punime si piktimi, rëlvime të ndryshme topografike në sisteme koordinative të ndryshme caktimi i kuotave të kërkuara nga projekti, azhornime të ndryshme dhe lidhjet me sistemet koordinative relative dhe absolute. Për këtë arsye operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues Teknik** në liçensën e shoqërisë, si mëposhtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili Strukturist)
- 1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- 1 (një) Inxhinier Elektrik

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues . si dhe në listepagesen e operatorit ekonomik për të paktën tre muajt e fundit.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

Për secilin pjestar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë kontratë pune e vlefshme, diplomë, librezë pune dhe CV, (Drejtuesit teknik të jenë të siguar sipas legjislacionit në fuqi)

Kriteri i mesiperm konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nen 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më

sipër kërkuar.

Në rastin konkret synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë staf të kualifikuar teknik për kryerjen e punimeve objekt kontrate.

Në nenin 8 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” parashikohet se “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.” Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane. Me materiale dhe produkte ndërtimi kuptohet çdo produkt i prodhuar për t’u përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit.”

Sa më sipër, në interpretim të dispozitave të mësipërme, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga personat të pajisur me licencë të cilët njëherazi mbajnë përgjegjësi për realizimin e punimeve në përputhje me kushtet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Lidhur me disponueshmërinë e Inxhinierëve të mësipërm, njësia e prokurimit gjykon se për sa kohë që autoriteti kontraktor në preventivin e punimeve ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshme disponueshmëria i një Inxhinier Ndërtimi, Hidroteknik, Gjeolog, Gjeodet si dhe mjedisi parë kjo në raport edhe me pikat dhe kategoritë përkatëse të licencës së kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, dhe referuar volumeve të punimeve të parashikuara në preventivin dhe në projektin përkatës, kriteri i mësipërm është në përputhje dhe proporcion me volumin e kontratës, si dhe në raport me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuar, vlerën dhe natyrën e saj, është një kërkesë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

➤ Inxhinier Ndërtimi (Profili Strukturist)

1 (një)

Nga zërat e preventivit dhe natyra e objektit të prokurimit dhe në zbatim të VKM 629 datë 13.05.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” janë përcaktuar numri i punonjësve dhe stafi i kualifikuar me licencë ose dëshmi të lëshuara nga autoritet e përcaktuara me ligj. Kërkesa për një inxh. Ndërtimi që të jenë në licencën e shoqërisë është vendosur në zbatim të Kodit të Punës, kohëzgjatja javore e punës 48 orë për një periudhë të gjatë pune (afati i realizimit të punimeve të kontratës është 4 muaj, në zbatim të VKM nr.42 datë 16.01.2008 Për Miratimin e Rregullores për Kriteret dhe Procedurat e Dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrijnë Veprimtari Ndërtimi”, pika II :c) Autoritetet kontraktore, në përcaktimin e grafikëve dhe afateve për përfundimin e punimeve të ndërtimit, në dokumentet e tenderit të prokurimit dhe në kontratën e zbatimit të veprave publike, ndërtimore, detyrohen të llogarisin kryerjen e punimeve, për periudhën 3 mujore, për ndërtimin e objekteve .

Specialiteti i inxhinierëve të ndërtimit është vendosur në zbatim të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 Kreu IV “Drejtuesi Teknik i shoqërisë dhe pa pajtueshmëria me këtë detyrë”.

Synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë staf të kualifikuar teknik

(inxhinier ndërtimi të cilët janë njëherazi dhe drejtues teknik) për kryerjen e punimeve në përputhje me kohëzgjatjen e parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe njëherazi në përputhje me turnet e parashikuar nga akti nënligjor në zbatim të ligjit. Në nenin 8 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Per Kontrollin Dhe Disiplinimin E Punimeve Te Ndertimit” parashikohet se “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.” Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane. Me materiale dhe produkte ndërtimi kuptohet çdo produkt i prodhuar për t'u përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit.”

➤ **Inxhinier Topograf/Gjeodet1 (një)**

Inxhinier topograf kërkohet për çdo punë ndërtimi ku ka shtrim rrugësh, rikonstruksione ose ndërtim banesash, punime ndërtimi, gjërmim kanali etj sepse ai merret me rievitimin e tokës, kuatot, profile tërthore dhe gjatësore, piketimet etj. Prania e topografit është e domosdoshme në terren për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë duke i dhënë garanci autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses.

➤ **Inxhinier Hidroteknik 1 (një)**

Duke analizuar objektin e kontratës, qëllimi i autoritetit kontraktor është zbatimi i punimeve me sukses dhe në kohë. Nisur nga volumet e punimeve, inxhinieri i mësipër është përgjegjës për udhëheqjen e punimeve në prezencën e ujit.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kërkesa për disponimin e një inxhinieri hidroteknik është i domosdosshëm dhe garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses.

➤ **Inxhinier Ndertimi (Profili gjeoteknik) 1 (një)**

Lidhur me kërkesën mbi disponimin si drejtues teknik të një ing. Gjeolog, referuar objektit të kontratës, ku ky i fundit shprehet se “Inxhinier ndertimi (profili gjeoteknik) është vendosur pasi tek specifikimet teknike është parashikuar se gjërmimi duhet të kryhet në përputhje me kuotat siç tregohet në vizatime. Kujdes i veçantë duhet të ushtrohet kur gjërmohen seksionet për të mos hequr material përtej vijës së specifikuar në projekt dhe më pas duke shkaktuar rrezikshmëri për qëndrueshmërinë e skarpave. Tabani i të gjithë gjërmimeve duhet të nivelohet me kujdes.

Për sa më sipër, duke analizuar preventivin e punimeve, projektin, relacionin teknik si dhe specifikimet teknike, njësia e prokurimit gjykon se kërkesa për disponimin e një inxhinieri gjeolog është në përputhje dhe vëllim të plotë të objektit të kontratës dhe garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve.

➤ **Inxhinier Mjedis 1 (një)**

Inxhinier Mjedis është kërkuar në kriteret e vecanta të kualifikimit për arsye se punimet në objekt do të kryhen në një zonë të cilës ka të domosdosshëm praninë e inxhinierit të mjedisit për arsye se zona pyjore ku kalon rruga ka prezencë të bimëve të ndryshme. Inxhinieri i mjedisit është zbatimi i punimeve shkencore dhe inxhinierike për të përmirësuar dhe mirëmbajtur mjedisin për mbrojtje të shëndetit të njeriut, mbrojtje të ekosistemeve të dobishme të natyrës, përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së jetës njerëzore në lidhje me mjedisin.

➤ **Inxhinier Elektrik 1 (një)**

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar punimet për zërat e preventivit të cilat përmbajnë punimet elektrike të cilat janë të konsiderueshme janë të argumentuara dhe të mbuluara nga pika e licences NP 11 A. Punimet elektrike kanë të domosdosshëm praninë e Inxhinierit Elektrik në këtë objekt.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, I shoqeruar me dokumentat:

- Libreze pune;
- Kontrate pune e vlefshme;
- Diplomë.

2.3.5Operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, për të paktën 3 (tre) muajt e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës si staf teknik punonjësit si më poshtë:

- Teknik Ndërtimi	2 (dy)
- Teknik Topograf/Gjeodet/Gjeometër	1 (një)
- Teknik i mesem Mekanik(shkolla e mesme)	1 (një)
- Teknik i mesem Elektricitet(shkolla e mesme)	2(dy)
- Teknik i mesem Hidraulik(shkolla e mesme)	1(një)
- Specialist Ndërtimi	1(një)
- Pllakashtrues	2(dy)
- Betonues	2 (dy)
- Hekurthyes	2 (dy)
- Karpentier	2(dy)
- Gurgdhendes	3 (tre)
- Saldator	1 (një)
- Automakinist	2 (dy)
- Buldozerist	2 (dy)
- Eskavatorist	2 (dy)
- Shofere me CAP	3 (tre)

Kriteri i mesiperm konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër kërkuar.

Përpara lidhjes së kontratës për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë:

Dëshmi kualifikimit të sigurimit teknik të cilat të jenë të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, **ose certifikata ekuivalente të tyre (të vlefshme)**, kontrate pune e vlefshme, certifikatat përkatëse si edhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për 3 (tre)

muajt e fundit.

Për manovratorët/shoferët duhet të paraqitet Dëshmi e Aftësisë Profesionale (të vlefshme) lëshuar nga institucionet përkatëse (DPSHTRR).

(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, mbështetës dhe të specializuar/kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale, apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).

Per profesionet si me sipër, operatori ekonomik duhet te plotesoje tabelën si me poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni	Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Nr NIPT (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1				
2				

Argumentimi në lidhje me pikën 2.3.4. Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Njësia e prokurimit sqaron se të gjithë punonjësit e kërkuar si më sipër me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknikapo çertifikata ekuivalente të tyre, përkohë me punimet sipas preventivit të publikuar në SPE, dhe konkretisht :

Për teknik ndërtimi 2 (dy) personatë pajisur me dëshmi aftësie profesionale 2 (dy) persona, nevojitet prezenca e tyre në kantier për objektin ne fjale duke garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses sipas projektit dhe preventivit.

Per teknik topograf/gjeodet/gjeometer persona të pajisur me dëshmi aftësie profesionale 2 (dy) persona, nevojitet prezenca e tyre në kantier për objektin ne fjale duke garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses sipas projektit dhe preventivit.

Teknik i mesemelektricitet 2 (dy) personatë pajisur me dëshmi aftësie profesionale 2 (dy) persona, nevojitet prezenca e tyre në kantier për objektin ne fjale duke garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses sipas projektit dhe preventivit duke patur parasysh qe kemi te bejme me punime elektrike te cilat kane nevojte per specialist te tille.

Teknik i mesemhidraulik personatë pajisur me dëshmi aftësie profesionale 2 (dy) persona, nevojitet prezenca e tyre në kantier për objektin ne fjale duke garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses sipas projektit dhe preventivit duke patur parasysh qe kemi te bejme me punime hidraulike te cilat kane nevojte per specialist te tille

Betonues 2 (dy) janë të nevojshëm pasi në zërat e preventivit përfshihen punimet e betonit sipas zerave te preventivit.

Hekurkthyes 2 (dy) janë te domosdoshem per realizimin e punimeve ne zbatim te zerave te preventivit per punime te natyres se tij te punes në përputhje me objektin e kontratës si dhe i shërben qëllimit të AK duke garantuar këtë të fundit për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Teknik i mesem mekanik eshte i domosdoshem per realizimin e punimeve ne zbatim te zerave te preventivit per punime te natyres se tij te punes në përputhje me objektin e kontratës si dhe i shërben qëllimit të AK duke garantuar këtë të fundit për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Specialist Ndertimi është i domosdoshëm për realizimin e punimeve në zbatim të zerave të preventivit për punime të natyrës së tij të punës në përputhje me objektin e kontratës si dhe i shërben qëllimit të AK duke garantuar këtë të fundit për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Pllakashtrues 2 (dy) është i domosdoshëm për realizimin e punimeve në zbatim të zerave të preventivit për punime të natyrës së tij të punës në përputhje me objektin e kontratës si dhe i shërben qëllimit të AK duke garantuar këtë të fundit për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë. Kjo e asyrtuar me faktin që në preventiv ka një kapitull të punimeve me zera punimesh suvatimi.

Punues Guri 3(tre) janë të domosdoshëm për realizimin e punimeve në zbatim të zerave të preventivit për punime të natyrës së tyre të punës në përputhje me objektin e kontratës si dhe i shërben qëllimit të AK duke garantuar këtë të fundit për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Karpentier 2 (dy) janë të domosdoshëm për realizimin e punimeve në zbatim të zerave të preventivit për punime të natyrës së tij të punës në përputhje me objektin e kontratës si dhe i shërben qëllimit të AK duke garantuar këtë të fundit për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë. Kjo e asyrtuar me faktin që në preventiv ka një kapitull të punimeve me zera punimesh dekorative si punime guri etj.

Saldator është i domosdoshëm për realizimin e punimeve në zbatim të zerave të preventivit për punime të natyrës së tij të punës në përputhje me objektin e kontratës si dhe i shërben qëllimit të AK duke garantuar këtë të fundit për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë. Kjo e asyrtuar me faktin që në preventiv ka një kapitull të punimeve me zera punimesh betoni.

Për Eskavatorist, Buldozerist, Automakinist, shofer me CAP janë të nevojshëm për manovrimin e mjeteve të kërkuar në DST dhe konkretisht : Kamion vetshkarkues me kapacitet jo më të vogël 28t, Kamion vetshkarkues me kapacitet jo më të vogël 12-13t, kamion vetshkarkues me kapacitet deri në 10 t, Kamioncine, Eskavator me zinxhir, Eskavator me gomë, Minieskavator / Bobkat, Buldozer, Rula ngjeshes, RTV - Transportier për mjete të renda etj

1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin

Është i domosdoshëm për monitorimin e gjendjes mjedisore gjatë zhvillimit të punimeve duke qënë se zona ka gjelberim të dendur Lumi Osum është në afërsi të zhvillimit të projektit dhe linxhat konsiderohen si burime me ujë kurativ për qëllime shëndetësore.

2.3.6 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë 1 (një) punonjës me certifikatë/ ose certifikatë trajnimit si **“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”** të lëshuara nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara nga DPA (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose certifikata ekuivalente të tyre (të vlefshme), si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) punonjës specialist që të disponojë certifikatë e trajnimit si **"Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë"** në përputhje me klauzola të ligjit Nr.10327, datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantiër".

Kriteri i mesiperm konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër kërkuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri dhe përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilet janë të certifikuar si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, si dhe “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” janë të nevojshëm për të menaxhuar emergjencat gjatë punimeve dhe të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit në punë.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 37 (tridhjet e shtate) punonjës për të paktën 3 muajt e fundit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për tre muajt e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë :

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit, për periudhën **si më sipër**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën **si më sipër**.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është

lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Referuar legjislacionit në fuqi, është përcaktuar se autoriteti kontraktues kërkon dëshmi për fuqinë punëtore me qëllim që të garantohet për realizimin me sukses të kontratës.

Si dhe referuar përmasave të kontratës që do të do të prokurohet, specifikimeve teknike, fondit limit, afatit të zbatimit të saj, si dhe kohëzgjatjes së parashikuar për realizimin e punimeve sipas grafikut të përcaktuar, njësia e prokurimit vlerëson se numri i punonjësve të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor në rastin konkret, garantohet për zbatimin e kontratës me sukses duke krijuar besueshmërinë dhe qëndrueshmëri të punonjësve tek operatorët ekonomik, si dhe duke mos sjellë vonesa në zbatimin e saj.

2.3.8 Operatorët ekonomik ofertues duhet të jenë të certifikuar sipas standarteve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, dhe konkretisht :

- ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë e vlefshme), **oseekuivalent**
- ISO 14001-2015(Sistemi i Menaxhimit Mjedisor e vlefshme), **oseekuivalent**
- OHSAS 45001-2018(Sistemi i Menaxhimit të sigurisë në punë), **oseekuivalent**.
- ISO 39001:2012 mbi (Per Sistemin e menaxhimit te sigurisë), e vlefshme, **ose ekuivalente**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Për vetë natyrën e veçantë dhe delikate, dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet si dhe afatit për zbatimin e saj.

Kjo certifikatë lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohet edhe certifikata ekuivalente të tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardin për menaxhimin e mjedisit për sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtëpërdrejtë në mjedis.

ISO (Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit) është një organizatë me anëtarësi e pavarur, jo-qeveritare dhe zhvilluesi më i madh në botë i Standardeve Ndërkombëtare, nga 163 vende të botës. ISO publikon më shumë se 19500 Standarde Ndërkombëtare, të cilat mbulojnë pothuajse çdo fushë industrie, nga teknologjia të siguria ushqimore, bujqësia e shëndeti. Në nivel botëror shoqëritë ndjekin adoptimin e standarteve të cilësisë me qëllim që të jenë të respektuar nga klientet e autoritetet shtetërore dhe të ndërtojnë bashkëpunim të qëndrueshëm me avantazhe reciproke.

➤ **ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalent**

Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të cilësisë, është **standarti më i njohur që është publikuar ndonjëherë në nivel nderkombëtar**. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxhial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilën AK kërkon ta kryejë me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, preventivin dhe vlerën e saj, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij që të kërkojë certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, që përpos punimeve që do të kryhen nga operatorët

ekonomik ofertues, këto punime të kryhen me cilësi sipas çertifikatës iso të mësipërme .

➤ **ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambjentit” e vlefshme, ose ekuivalent**

Ky çertifikim shërben në lidhje me sistemet e menaxhimit mjedisor, me anë të së cilës garantohen mundësitë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një subjekti me synim parandalimin e dëmtimit të mjedisit, respektimin e legjislacionit vendas në lidhje me mjedisin dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Gjithashtu, ky çertifikim fokusohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të subjektit, duke bërë të mundur të përmirësohet ndikimi i veprimtarisë së përgjithshme të subjektit në aspektin mjedisor .

Kjo çertifikat është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Referuar objektit të prokurimit në rastin konkret, njësia e prokurimit e ka parë të nevojshme që shoqëritë të jenë të çertifikuara nga organizata ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit të mjedisit sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi të, duke kryer një proces riaftësimi më pas të ambjentit përreth ku do të kryhet investimi.

➤ **ISO 45001-2018(Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë)e vlefshme,ose ekuivalenti saj**

Është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar që përcakton kërkesat për njësis të menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë .

Kjo certificate garanton sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve që marrin pjesë gjatë një procesi prodhimi apo kryerjes së një veprimtarie apo pune publike e cila vë apo mund të vërë në rezik shëndetin dhe jetën e punonjësve. Është e lidhur ngushtë dhe në përpjestim me objektin e kontratës, sipas parashikimeve të LPP.

Autoriteti kontraktor përpos punimeve që do të kryejë, kërkon që këto punime ti zhvillojë në përputhje dhe garanci të plotë me sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve .

➤ **ISO 39001:2012 mbi (Per Sistemin e menaxhimit të sigurisë), e vlefshme, ose ekuivalente.**

Është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar që përcakton kërkesat për një sistem të menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor për t'i mundësuar një organizate që ndërvepron me sistemin e trafikut rrugor të reduktojë dëmtimet serioze që lidhen me aksidentet në trafikun rrugor, të cilat mund të ndikojë. Duke patur parasysh që ne kete rast kemi të bëjmë me punime në rrugë komisioni ka gjykuar se është e domosdoshme që operatori ekonomik ofertues të jetë i certifikuar me kete standart ISO.

2.3.9 Operatorët ekonomik ofertues për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet teknike si më mëposhtme :

Nr.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Gjendja
1	Eskavator me goma (mjet teknologjik)	1 copë	Në pronësi ose me qera
2	Eskavator me Zinxhir (19-24 ton)	2 cope	Ne pronesi ose me qera
3	Mini Eskavator me Zinxhir (8-9 ton)	1 cope	Ne pronesi ose me qera
4	Mini Eskavator me Zinxhir Gome (3-4 ton)	1 Cope	Ne pronesi ose me qera

5	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 28 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
6	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 24 ton	1 cope	Ne pronesi ose me qera
7	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 12-13 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
8	Kamion Me Vinc	1 cope	Ne pronesi ose me qera
9	Kamionçina me kapacitet mbajtës deri në 3.5-5 ton	1copë	Në pronësi ose me qera
10	Kamionçina me kapacitet mbajtës deri në 1-1.5 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
11	Autovinc deri 5-6 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
12	Grejder (mjet teknologjik)	1 cope	Ne pronesi ose me qera
13	Fadrome me goma (mjet teknologjik)	1 copë	Në pronësi ose me qera
14	Minifadrome (mjet teknologjik)	1 copë	Në pronësi ose me qera
15	Minidumper (mjet teknologjik)	1 copë	Në pronësi ose me qera
16	Rrul me Vibrim Gome Hekur (8-9 ton)	1 cope	Ne pronesi ose me qera
17	Rrul me Vibrim Hekur-Hekur (4-5 ton)	1 cope	Ne pronesi ose me qera
18	Rimorkiator per Mjetet e Renda RTV(kapacitet mbajtes min 24 ton)	1 cope	Ne pronesi ose me qera
19	Autobetoniere	2 Cope	Në pronësi ose me qera
20	Autopompe Betoni	1 copë	Në pronësi ose me qera
21	Autobot uji	1 copë	Në pronësi ose me qera
22	Vibratorë betoni	2 copë	Në pronësi ose me qera
23	Motogjeneratorë	2 copë	Në pronësi ose me qera
24	Tabela sigurimi në punë	40 copë	Në pronësi ose me qera
25	Matrapik	2 copë	Në pronësi ose me qera
26	Kontenierë për puntorë	4 copë	Në pronësi ose me qera
27	Jelekë, kokore	37 copë	Në pronësi ose me qera
28	Kominoshe puntorësh	37 copë	Në pronësi ose me qera
29	Rripa sigurimi	10 copë	Në pronësi ose me qera
30	Prozhektor ndriçimi	5 copë	Në pronësi ose me qera
31	Fikse zjarri	10 copë	Në pronësi ose me qera
32	Kuti ndihme e shpejtë	3 copë	Në pronësi ose me qera
33	Karro Dore	10 copë	Në pronësi ose me qera
34	Doreza Puntorësh	37 copë	Në pronësi ose me qera
35	Maska hunde	37copë	Në pronësi ose me qera
36	Depozita uji(min 5000 litra)	2 cope	Ne pronesi ose me qera
37	Depozitë materialesh	2 copë	Në pronësi ose me qera
38	Autovinc me kosh	1 copë	Në pronësi ose me qera
39	Paisje saldimi me elektrofuzion	1copë	Në pronësi ose me qera
40	Buldozer	1 cope	Ne pronesi ose me qera
41	Impiant Prodhim Inertesh(QKL)	1 cope	Ne pronesi,qera,kotrat furnizimi
42	Ipmiant Prodhim Betoni (QKL)	1 cope	Ne pronesi,qera,kotrat furnizimi
43	Impiant thyerje Guri (QKL)	1 cope	Ne pronesi me qera,kontrat furnizimi
44	Aparat topogjendezik	1 cope	Ne pronesi ose qera

Kriteri i mesiperm konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më

sipër kërkuar.

- a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik si dhe certifikatën e transportit të mallrave (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme).
- b) Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik si dhe certifikatën e transportit të mallrave (të vlefshme), siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës object I këtij prokurimi.

Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdo ganimit ose faturat tatimore të blerjes.

- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.
- d) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës përkatëse. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- e) Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara më sipër do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati I zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekti prokurimit janë shkak për skualifikim. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtue dhe gjatë zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar ligjvënësi i jep të drejtën autoritetit kontraktor të kërkojë nga ana e operatorëve ekonomik dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve të ndërtimit dhe preventivit të hartuar nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Dimal, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve. Për realizimin e kontratës me sukses dhe në kohë autoriteti kontraktor kërkon garanci nga operatorët ekonomik ofertues të cilët duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme, gjithçka në funksion të zbatimit të kontratës.

Duke parë volume e punimeve, afatin për realizimin e saj, vlerën e kontratës, relacionin teknik është e nevojshme që operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se disponojnë mjetet e mësipërme për realizimin me sukses dhe në kohë të objektit të prokurimit .

2.3.10 Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të disponojnë:

ImpiantprodhimInertesh per betonin me QKL	1 cope	Pronësi ose me qira
Linje per thyerje Guri me QKL	1 cope	Pronësi ose me qira

Per sa mesiper duhet te paraqesin dokumentacionin e pronesise apo marrjes me qera, te shoqeruar me leje mjedisore te leshuar nga QKL si meposhte :

-QKL – Leje Mjedisi te tipit B, Kodi: III.1.B “Per impiant betoni, prodhimin e produkteve te betonit, shoqeruar me planvendosjen per Impiantin, monitorimin mjedisor.

-QKL – Leje Mjedisi Kodi: III.1.B. “Per Impiant Inertesh”

-QKL – Leje Mjedisi Kodi: III.1.B. “Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret” per linjen e thyerjes se gurit.

-QKL – Leje Mjedisi Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve jo te rreikshme”, shoqeruar me aktin e miratimit.

Sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI/MEI apo Ministria kompetente e linjes.Shoqëritë e huaja duhet te kene kryer ekuivalentimin (njehsimin) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktures, Republika e Shqipërisë, sic percaktohet ne Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM Nr.42, date 16.01.2008

Cdo ofertues do te paraqese edhe **Grafikun i Punimeve** në përputhje me afatin e realizmit të punimeve te kerkuar.

2.3.11. Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor /nënkontraktor për kontratë / kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “*periudhë*” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit / investimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Referuar frymës së legjisllacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin

konkret është në të drejtën e autoritetit të kërkojë garanci lidhur me mundësitë e operatorëve ekonomik për sigurimin e lëndës bazë dhe materialeve që do të përdoren për realizimin e objektit, përsa kohë lejohet provueshmëria e disponimit nëpërmjet edhe kontratave të furnizimit sikurse autoriteti kontraktor ka përcaktuar në DST, duke e lenë të hapur përmbushjen e këtij kriteri në respekt të plotë të ligjit të prokurimit publik.

Lejet mjedisore të kërkuara në këtë procedurë prokurimi i japin garancinë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ofertues ka licencimin dhe impietet e duhura për realizimin e kontratës.

Në preventin e punimeve, autoriteti kontraktor ka parashikuar punime shtresash dhe asfalti dhe inerte në sasi të konsiderueshme.

Duke parë volume të mëdha të punës që do të kryhen, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij të kërkojë garanci nga ofertuesit për përmbushjen me sukses të çdo zëri të preventivit të punimeve.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

NJËSIA E PROKURIMIT

Marije Bizdani

Gerald Bolani

Mateo Plaku